


Kosova synon të formojë forcë ushtarake dhe t'i bashkohet NATO-s

Derisa SHBA-ja e mbështet shtetësinë e Kosovës, zyrtarët e Ambasadës amerikane në Prishtinë nuk kanë dashur që të komentojnë shtytjen e Kosovës për një ushtri, duke thënë vetëm se SHBA-ja e mbështet Forcën aktuale të Sigurisë në Kosovë dhe rishikimin e sektorit të sigurisë, të mbikëqyrtur nga këshilltarët ushtarakë amerikanë

Foto: Alban Bujari



PRISHTINË, 25 DHJETOR – Gati pesë vjet pasi që Kosova shpalli pavarësinë, përkrahësit ndërkombëtarë të saj janë duke e inkurajuar këtë shtet të vogël të Ballkanit që t'i bëjë vetë hapat e radhës.

Një nga këta hapa mund të jetë formimi i një ushtrie të vogël prej forcës 2.500 anëtarëshe ekzistuese të mbrojtjes civile – një detyrë kjo e vështirë për një shtet të ri, që ende nuk e ka siguruar njohjen e plotë ndërkombëtare dhe që përcillet me skepticizëm të thellë nga fqinji verior, Serbia, prej së cilës shpalli pavarësinë më 2008.

Gati 6.500 ushtarë të NATO-s, përfshirë rreth 800 amerikanë, mbesin të stacionuar në Kosovë, për të ndihmuar në ruajtjen e paqes me serbët, që refuzojnë ta njohin qeverinë e ish-provincës serbe, ku 90 për qind e popullatës janë shqiptarë.

"Ne duhet të japim siguri, e jo të konsumojmë siguri", ka thënë Rexhep Selimi, anëtar i Komitetit të Kuvendit të Kosovës që mbikëqyr këtë forcë.

"Për këtë arsye duam që ta kryejmë punën sa më shpejt të jetë e mundur, në mënyrë që të mund të anëtarësohemi në NATO".

Derisa SHBA-ja e mbështet shtetësinë e Kosovës, zyrtarët e Ambasadës amerikane në Prishtinë nuk kanë dashur që të komentojnë shtytjen e Kosovës për një ushtri, duke thënë vetëm se "SHBA-ja e mbështet Forcën aktuale të Sigurisë në Kosovë dhe rishikimin e sektorit të sigurisë, të mbikëqyrtur nga këshilltarët ushtarakë amerikanë".

"Një gjë të tillë e konsiderojmë mundësi të mirë, që ata ta analizojnë mirë se çfarë drejtimi kanë marrë", ka thënë kolonellejtanti i Ushtrisë amerikane, Ray Wojcik, drejtuari i Zyrës për Bashkëpunim në fushën e Mbrojtjes, në kuadër të Ambasadës amerikane.

Shpallja e pavarësisë nga Kosova, në shkurt të vitit 2008, ishte bërë gati nëntë vjet pas bombardimeve të NATO-s, për t'i dhënë fund përdorimit të forcës nga serbët ndaj popullsisë shumicë shqiptare në Kosovë. Ajo vazhdon që ta ndajë opinionin botëror.

Rusia, e cila si aleat e Serbisë ka refuzuar që ta njohë pavarësinë e Kosovës, ka të drejtën e vetos në Këshillin e Sigurimit të OKB-së dhe

mund ta mbajë Kosovën jashtë këtyj trupi botëror. Pesë shtete anëtare të Bashkimit Evropian, përfshirë katër anëtare të NATO-s, nuk e njohin Kosovën, duke penguar aspiratat e Kosovës për anëtarësim në ato organizata.

Sidoqoftë, forcat e NATO-s kishin ndihmuar në krijimin e Forcës së Sigurisë të Kosovës, me gjithë ndasitë e brendshme të aleancës rreth statusit të Kosovës. FSK-ja është e specializuar në deminim, kërkim dhe shpëtim, midis detyrave të tjera.

"Nuk është absolutisht e qartë nëse të gjithë aleatët do të marrin pjesë në këto detyra të reja, por NATO-ja, si aleancë, do ta bëjë një gjë të tillë", u pat thënë gazetarëve në qershor të 2008-s, sekretari i atëhershëm i përgjithshëm i NATO-s, Jaap de Hoop Scheffer.

Dhe, në të vërtetë, shteteve të caktuara iu la barra më e madhe e stërvitjes dhe pajimit të forcës. Kryesorja në mesin e tyre ishte SHBA-ja, që mbetet përkrahësja më e madhe e Kosovës, thotë Wojcik. Ajo siguron një shumë prej 5.5 deri në shtatë milionë dollarë për stërvitje dhe pajisje ushtarake, midis formave të tjera të ndihmës, ka bërë të ditur Ambasada amerikane. Buxheti i FSK-së është rreth 35 milionë dollarë.

SHBA-ja kishte siguruar uniformat dhe radiolidhjet, duke i hapur shkollat e veta për pjesëtarët e FSK-së, përfshirë Akademinë Ushtarake në Fort Bliss të Texasit dhe Kolegjin për Komandë dhe Shtab të Përgjithshëm. Ajo çiftëzoi Kosovën me Gardën Nacionale të Iowas dhe dërgoi anëtarë të FSK-së në Grafenwohr të Gjermanisë për stërvitje.

Trajnimit e tilla tani po inkorporohen në strukturën e FSK-së, me ndihmën e Ushtrisë amerikane. Gjatë një ceremonie, në shtator, në bazën e FSK-së në Ferizaj, këshilltarët ushtarakë amerikanë shikonin, derisa rreth njëzet eporë të lartë përfunduan një kurs që ishte organizuar brenda Kosovës, kryesisht nga vetë pjesëtarët të FSK-së.

"SHBA-ja është partnerja jonë strategjike dhe do të mbetet partnerja jonë strategjike", tha komandanti i FSK-së, gjenerallejtanti Kadri Kastrati. "Gjithçka që ne

ndërmarrim bëhet në koordinim me atëshe ushtarakë amerikanë në Prishtinë dhe me kolegët tanë që punojnë këtu në Ekipin Këshillues të NATO-s apo të Zyrës për Bashkëpunim në Fushën e Mbrojtjes".

Ushtria amerikane ka po ashtu rëndësi të jashtëzakonshme në fazën e ardhshme të forcës së Kosovës. Iniciativa për Reforma në Mbrojtje, që vepron brenda Departamentit të Mbrojtjes, është duke e mbikëqyrtur rishikimin e sektorit të sigurisë nga Qeveria e Kosovës, rishikim ky që filloi në mars si riorganizim i strukturës së sigurisë në Kosovë.

Rishikimi ka rëndësi të madhe, duke pasur parasysh të rejtat në këtë shtet. Në shtator, përkrahësit ndërkombëtarë të Kosovës u tërhoqën, për t'i dhënë shtetit sovranitet të plotë mbi ligjet e veta. Njëri, Ligji për FSK-në, është i hapur për ristrukturim në qershor të vitit 2013.

Agim Çeku, ministër aktual i FSK-së dhe ish-kryeministër, thotë se një forcë mbrojtëse është domosdoshmëri.

"Ne jo vetëm që po ndërtojmë shtet, por jemi duke ndërtuar shoqëri këtu", ka thënë Çeku në një intervistë, pak kohë më parë.

"Dhe mendoj se forca ushtarake është një faktor i rëndësishëm i identitetit nacional për ne", thotë Çeku, që ka luftuar në luftën e Kroacisë për pavarësi nga ish-Jugosllavia dhe ka qenë gjeneral në Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës, që mori armët kundër Serbisë në fund të viteve nëntëdhjetë. Ai konsiderohet kriminel lufte nga Serbia. "Forca ushtarake është instrument shumë i mirë për modernizimin e shoqërisë. Këtu ne mund të shërbejmë si shembull, shembull i mirë, i disiplinës, i shërbimit për kombin, i përkushtimit për detyrë".

Si Çeku, ashtu edhe Kastrati, komandanti i FSK-së, synojnë një forcë të vogël, të krijuar në pajtim me standardet e NATO-s, që do të mund të angazhohet edhe për kapacitete të specializuara, si çmimin, apo kërkimi dhe shpëtimi, ngjashëm me atë që FSK-ja bën tani.

"Ne nuk po synojmë të balancohemi me ndoajë shtet tjetër, thjesht duam të përmbushim nevojat tona në fushën e sigurisë, të cilat do të

mbuloreshin me buxhetin tonë", ka thënë Çeku. "Dhe jo të përbëjmë – posaçërisht kjo – jo të përbëjmë kërcënim për dikë".

Shumë liderë të Kosovës dhe disa analistë planifikojnë një të ardhme brenda NATO-s. Ndërkohë, është e qartë se si do ta konsideronte aleanca ushtrinë e Kosovës.

Madje, edhe statusi i FSK-së mbetet pikë mospajtimi. Shtetet anëtare të NATO-s janë ende duke e shqyrtuar nëse duhet ta miratojnë emërtimin kryesisht teknik të forcës – që ka arritur "Kapacitetin e plotë operacional" – që është dhënë nga vetë komandantët i forcave të NATO-s në Kosovë, nëntorin e kaluar. SHBA-ja e mbështet një gjë të tillë.

"Është diçka, rreth së cilës mundohemi të arrijmë konsensus më të gjerë, duke e lëvizur në drejtimin e duhur", ka thënë Michael Kreidler, zyrtar politik-ushtarak në Ambasaden amerikane në Kosovë. "Por procesi i arritjes së konsensusit në Bruksel është mundues".

Një shqetësim tjetër ndërkombëtar, i lidhur me krijimin e një ushtrie në Kosovë është gjendja e tensionuar e sigurisë në veriun e Kosovës, ku serbët refuzojnë çfarëdo përfaqësimi të Qeverisë së Kosovës. Trazirat shpërthyen vitin e kaluar, pasi që Policia e Kosovës hyri në këtë territor, për vendosjen e zyrave të doganave në kufi me Serbinë.

Ilir Deda, ish-shef i stafit të presidentes së Kosovës, Atifete Jahjaga, që tani është drejtor i Institutit të Kosovës për Hulumtime Politike dhe Zhvillim, beson se madje edhe me një marrëveshje për veriun, shtetet në NATO që nuk e njohin Kosovën mund të mos e mbështesin idenë e një ushtrie. Ai ka shtuar se Kosova duhet të përqendrohet tek përkrahësit e saj më me ndikim.

"Po që se ndodh një gjë e tillë, atëherë e ka mbështetjen e SHBA-së dhe të Britanisë së Madhe", ka thënë ai.

Është ky një mendim që përsëritet nga zyrtarët e Kosovës, si Çeku.

"Ata tani po e mbështesin procesin këtu", ka thënë ai. "Këtë proces do ta ndërmarrim së bashku. Thashë se nuk do të paraqes ndonjë rekomandim që nuk koordinohet me SHBA-në dhe nuk pranohet nga SHBA-ja".

»SHBA-të e duan Kosovën në NATO, sa më shpejt

AMERIKA PO E BËN USHTRINË E KOSOVËS



Shteti që ka bërë më së shumti në çlirimin dhe bërjen e shtetit të Kosovës, janë Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Tani ato po e bëjnë edhe ushtrinë e Kosovës të cilën sa më shpejt duan ta kenë në NATO, shkruan portali ushtarak amerikan "Stars and Stripes"

Prishtinë - Shtetet e Bashkuara të Amerikës, janë të interesuar që Kosova sa më shpejt të ndërtojë një ushtri, që ajo të jetë edhe pjesë e NATO-s, shkruan portali ushtarak amerikan "Stars and Stripes".

Amerikanët shpenzojnë miliona dollarë në vit për trajnimin dhe armatosjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës.

Një nga hapat e parë të Kosovës; në bazë të "Stars and Stripes" mund të jetë për të krijuar një ushtri të vogël prej 2.500 njerëzve, që aktualisht vijnë nga forcat e sigurisë civile. "Kjo është një detyrë e vështirë për një komb të ri që nuk ka ende njohje të plotë ndërkombëtare. E gjithashtu kufizohet me fqinjën e saj verior i cili e pretendon territorialisht vendin i cili e shpalli pavarësinë

në vitin 2008", shkruan portali ushtarak amerikan.

Ndërsa Shtetet e Bashkuara mbështesin fuqishëm Kosovën, zyrtarët e ambasadës amerikane në Prishtinë nuk kanë dashur të komentojnë rreth synimeve të Kosovës për forcë ushtarake. Në këtë ambasadë thonë se SHBA aktualisht mbështet Forcën e Sigurisë së Kosovës dhe riorganizimin e saj në të ardhmen, që do të bëhet me ndihmën e këshilltarëve nga ushtria e Shteteve të Bashkuara.

Serbia dhe vendet mike të saj, kundërshtuan shpalljen e pavarësisë së Kosovës në vitin 2008.

"Rusia, e cila është një aleat i madh i Serbisë, ka refuzuar të njohë pavarësinë e Kosovës, dhe ajo ka të drejtën e vetos në Këshillin e Sigurimit të OKB-së,

duke bërë të mundur bllokimin e anëtarësimit të Kosovës. Gjithashtu, edhe pesë vendet anëtare të BE-së, përfshirë edhe katër anëtare të NATO-s, nuk e njohin vendin, duke penguar aspiratat për anëtarësim në këto organizata", thuhet në tekstin e portalit ushtarak amerikan.

Nga 5 600 ushtarë të forcës ushtarake ndërkombëtare KFOR që ndodhen në veri të vendit, 800 prej tyre janë amerikanë.

SHBA vazhdon të jetë mbështetësi më i fuqishëm i Forcës së Sigurisë së Kosovës, me buxhet prej 32 milionë dollarësh amerikanë në vit.

Amerikanët ofrojnë uniforma dhe pajisje, si radio e të tjera për FSK-në. Pjesëtarët e kësaj force madje marrin edhe shkolim nëpër akademitë ushtarake

amerikane në Amerikë dhe Gjermani.

"SHBA-ja është partneri ynë strategjik dhe gjithmonë do të jetë partneri i parë strategjik yni. Çdo gjë që bëjmë, e bëjmë në koordinim me atashë ushtarake amerikane në Prishtinë dhe kolegët tanë që punojnë në Ekipin Këshillues të NATO-s dhe Zyrës së Operacioneve të Ambasadës Amerikane në Prishtinë", u ka thënë portalit amerikan, Komandanti i FSK-së, Kadri Kastrati. Ministri i Forcës së Sigurisë së Kosovës, Agim Çeku i ka thënë këtij portali, se ushtria amerikane do të ketë rolin kryesor në riorganizimin e FSK-së. Kjo forcë sipas ministrit Çeku, do të fillojë riorganizimin në qershor të vitit 2013, për të marrë statusin ushtarak.

ShBA-ja formon ushtrinë e Kosovës

Portali ushtarak amerikan "Stars and Stripes" ka shkruar se ShBA-ja dëshiron ta formojë ushtrinë e Kosovës në mënyrë që Kosova sa më shpejt të anëtarësohet në NATO. Hapi i parë në këtë drejtim është formimi i ushtrisë së vogël nga Forcat aktuale të Sigurisë së Kosovës

PRISHTINE, 25 DHJETOR - Shtetet e Bashkuara të Amerikës (SHBA) dëshirojnë ta formojnë Ushtrinë e Kosovës, e cila në një afat sa më të shkurtër do t'i bashkohej NATO-s, shkruan portali ushtarak amerikan "Stars and Stripes". Gati pesë vjet qëkur Kosova ka shpallur pavarësinë, lojtarët e mëdhenj ndërkombëtarë inkurajojnë shtetin e vogël ballkanik të ecë vetë përpara. Njëri nga hapat e parë, siç thotë portali, do të mund të ishte krijimi i një ushtrie të vogël nga aktualisht 2.500 persona të Forcës së Sigurisë së Kosovës. "Kjo është një detyrë e vështirë për kombin e ri që ende nuk e ka siguruar njohjen e plotë ndërkombëtare dhe që gjithnjë shqetësohet nga fqinjë i saj verior Serbia, nga e cila ka shpallur pavarësinë në vitin 2008", shkruan në portalin amerikan ushtarak.

Në tekst përmendet citati i deputetit të Kuvendit të Kosovës, Rexhep Selimi: "Ne do të duhej të prodhojmë siguri, e jo ta zbrazim sigurinë. Kjo është arsy-

ja që ne sa më parë dëshirojmë që ta kryejmë anëtarësimin në NATO".

Në vazhdim thuhet se aleati i Serbisë, Rusia, e cila e ka të drejtën e vetos në Këshillin e Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, është garanci se Kosova nuk do të anëtarësohet në këtë organizatë. Po ashtu, thuhet se edhe pesë vendet anëtare të BE-së (nga të cilat katër janë anëtare të NATO-s), të cilat pengojnë anëtarësimin e Kosovës në këtë organizatë.


Për këtë arsye, konsiderohet se Kosova më së shumti ka gjasa që të hyjë në Aleancën e NATO-s. Në këtë tekst ShBA-ja paraqitet si aleati më i madh i Kosovës në procesin e përafërimit në Aleancën Veriatlantike. Po ashtu, në këtë tekst janë paraqitur edhe të dhënat e Ambasadës amerikane, sipas të cilës ShBA-ja ndan çdo vit prej 5,5 milionë deri në 7 milionë dollarë për stërvitje, furnizim me armë dhe mënyra të tjera të ndihmës për Forcën e Sigurisë së Kosovës.

ShBA-ja ka furnizuar me uniforma dhe

radio-aparate dhe ka hapur shkollat e saj ushtarake për pjesëtarët e FSK-së dhe këto trajnime dhe stërvitje janë inkomporuar në strukturën e tyre.

Për të treguar se në ç'masë Kosova mbështetet në ShBA-në, portali ka përcjellë citatin e komandantit të FSK-së, Kadri Kastrati, të ketë thënë se ShBA-ja është partner strategjik i Kosovës dhe kështu do të mbetet përgjithmonë. "Gjithë çka bëjmë, e bëjmë në koordinim me atasheun ushtarak amerikan në Prishtinë dhe me kolegët të cilët punojnë në ekipin këshillues të NATO-s apo Zyrën për bashkëpunim të mbrojtjes", ka theksuar Kastrati.

Portali ka cituar edhe ministrin e FSK-së, Agim Çeku, të ketë thënë se në Kosovë nuk po krijohet vetëm shteti, por edhe shoqëria. "Ushtria është faktor shumë i rëndësishëm i identitetit kombëtar", konsideron Çeku. Kastrati dhe Çeku kanë theksuar se janë të përkushtuar për përmbushjen e standardeve të NATO-s.



TRANSFORMIMI I FSK-së

Kosova dëshiron ta formojë ushtrinë dhe t'i bashkohet NATO-s



Shkruan: Steven Bardsli ("Stars and Stripes")

- Njëri nga hapat e ardhshëm të Kosovës mund të jetë formimi i një ushtrie të vogël, nga një forcë mbrojtëse civile, e përbërë nga 2.500 vetë

Gati pesë vjet pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës, mbështetësit e saj ndërkombëtarë janë duke e inkurajuar këtë vend të vogël ballkanik që të pavarësohet me të vërtetë. Njëri nga hapat e ardhshëm të Kosovës mund të jetë formimi i një ushtrie të vogël, nga një forcë mbrojtëse civile, e përbërë nga 2.500 vetë, gjë që është një detyrë e vështirë për një shtet të ri, i cili ende nuk gëzon një njohje të plotë ndërkombëtare dhe nuk gëzon besimin e fqinjët të tij verior, Serbia, nga i cili edhe e shpalli pavarësinë në vitin 2008.

Trajnimet

Të 5,600 trupat e NATO-s, duke përfshirë edhe afër 800 amerikanë, vazhdojnë që të qëndrojnë në Kosovë, me qëllim që të ofrojnë ndihmë për ruajtjen e paqes me serbët etnikë, të cilët refuzojnë që ta njohin Qeverinë e Kosovës, ku 90% të popullsisë janë shqiptarë etnikë.

"Ne duhet të bëhemi prodhues të sigurisë, e jo të jemi konsumues të saj", thotë Rexhep Selimi, anëtar i Kuvendit të Kosovës, respektivisht i komitetit të tij që mbikëqyr forcen aktuale. "Për këtë shkak, ne duam që ta kryejmë punën tonë sa më parë që të jetë e mundur, në mënyrë që të mund të hyjmë në NATO."

Edhe pse SHBA-ja mbështet shtetësinë e Kosovës, zyrtarët e Ambasadës amerikane në Prishtinë kanë mohuar që të komentojnë rreth dëshirës së Kosovës për të pasur ushtri, duke thënë vetëm se SHBA-ja mbështet Forcën (aktuale) të Sigurisë së Kosovës dhe një rishikim të sektorit të sigurtë, të udhëhequr nga këshilltarët ushtarakë amerikanë.

"Kjo sipas nesh ofron një rast të mirë për ta, që të analizojnë me vëmendje se ku janë duke shkuar", thotë zëvendëskoloneli i SHBA-së, Rik Vojcik, kreu i Zyrës së ambasadës për bashkëpunim në fushën e mbrojtjes.

Vendete të veçanta të NATO-s iu është lënë që ta bartin pjesën më të madhe të barrës për trajnimin dhe pajisjen e FSK-së. Vendi kryesor midis tyre ishte SHBA-ja, e cila mbetet mbështetësi më i madh i Kosovës, sipas Vojcikut. SHBA-ja ofron midis 5.5 dhe 7 milionë dollarëve në vit në formë të trajnimeve dhe pajisjeve ushtarake, përpos formave të tjera të ndihmave, thonë në

Buxheti i FSK-së sillet rreth 35 milionë dollarë

Ambasadën amerikane. Buxheti i FSK-së sillet rreth 35 milionë dollarë.

Furnizimi me uniforma e pajisje

SHBA-ja e furnizon atë me uniforma dhe radio dhe ka hapur shkollat e veta për pjesëtarët e FSK-së, duke përfshirë edhe Akademien kryesore të rreshterëve ushtarakë në Fort Bliss, Teksas, si dhe Kologjin e komandës dhe gjeneralëve. SHBA-ja e ka binjakëzuar Kosovën me Gardën kombëtare të Ajoës, me qëllim të krijimit të një raporti të mentorimit dhe për të dërguar anëtarët e saj në Grafenvohr, Gjermani, për trajnimin NCO.

Një trajnim i tillë tani është duke u inkuoruar në strukturën e FSK-së, falë ndihmës ushtarake amerikane. Në një ceremoni të mbajtur në shtator në një bazë të FSK-së në qytetin e Ferizajt, këshilltarët ushtarakë amerikanë patën rastin të shihnin rreth 25 të diplomuar të kartë NCO, të cilët kishin kryer një kurs të zhvilluar në vend, kryesisht nga trajnuesit e FSK-së.

"SHBA-ja është partneri ynë strategjik dhe ajo du të jetë e tillë përjetë", thotë komandanti i FSK-së, zëvendësgjenerali Kadri Kastrati. "Çdo gjë që jemi duke bërë, e bëjmë në koordinim me atashen ushtarak të SHBA-së në Prishtinë dhe me kolegët tanë që punojnë këtu në Ekipin apo Zyrën këshilluese të NATO-s për Bashkëpunim ushtarak".

Ushtria e SHBA-së është e dobishme edhe në fazën e ardhshme të FSK-së. Iniciativa Reformuese e Institutit të Mbrojtjes, në kuadër të Departamentit të Mbrojtjes, është duke udhëhequr rishikimin e sektorit të sigurtë së Qeverisë së Kosovës, i cili filloi në mars si një rishikim i strukturës së sigurisë së Kosovës.

Ky rishikim ka rëndësi në dritën e ndryshimeve të fundit në vend. Në shtator, mbështetësit ndërkombëtarë të Kosovës u deklaruan për t'i dhënë këtë vend një sovranitet të plotë mbi ligjet e veta. Njëri nga ato ligje, ai i FSK-së, do të ristrukturohet në qershor të vitit 2013. Agim Çeku, ministri aktual i FSK-së, si dhe ish-kryeministri, thotë se një forcë mbrojtëse është e domosdoshme.

"Ne tani nuk jemi vetëm duke ndërtuar një shtet, por edhe një shoqëri", tha Çeku në një intervistë.

"Dhe, unë mendoj se forca ushtarake është një faktor i rëndësishëm i identitetit kombëtar për ne", tha Çeku, i cili mori pjesë në luftën e Kroacisë për pavarësi nga ish-

2013

do të jetë viti kur pritet ristrukturimi i FSK-së.

Jugosllavia dhe shërbeu si gjeneral në UÇK, e cila rroku armët kundër Serbisë në fund të viteve 1990, për shkak të kërkesave për pavarësi. Ai konsiderohet kriminel i luftës në Serbi. "Forca ushtarake është një instrument shumë i mirë për modernizimin e shoqërisë. Në këtu mund të shërbejmë si shembull i mirë i disiplinës, shërbimit ndaj popullit dhe përkushtimit ndaj obligimeve tona".

Si Çeku po ashtu edhe Kastrati, komandanti i FSK-së, parashohin një forcë të vogël, të zhvilluar sipas standardeve të NATO-s, me aftësi speciale, sikur që është çerçimimi, apo operacionet e krimit-shpëtim, të ngjashme me ato që kryen tani FSK-ja. "Ne nuk kërkojmë që të balancohem me ndonjë vend tjetër, vetëm që të plotësojmë nevojat tona të sigurisë dhe të jemi të përbalueshëm për buxhetin tonë", thotë Çeku. "Dhe, sidomos të mos paraqesim kërcënim për askënd".

"Konsensusi në Bruksel është i vështirë"

Shumë liderë të Kosovës dhe disa analistë parashikojnë një të ardhme në NATO. Në ndërkohë, mbetet e paqartë sesi do ta shihnte kjo aleancë një ushtri të Kosovës. Bile edhe statusi i FSK-së mbetet i diskutueshëm. Vendet anëtare të NATO-s ende janë duke shqyrtuar a të aprovonin një përcaktim kryesisht teknik të kësaj force - se ajo ka arritur "Aftësitë e plota operative" - të deklaruar nga komandanti i Forcave të NATO-s në Kosovë nëntorin e kaluar. SHBA-ja e mbështet një gjë të tillë. "Ne jemi duke u munduar që të arrijmë një konsensus të gjerë rreth kësaj çështjeje dhe të shikojmë në një drejtim pozitiv", thotë Majkell Kridler, zyrtar politik-ushtarak në Ambasadën e SHBA-së në Kosovë. "Por, procesi i arritjes së konsensusit në Bruksel është i vështirë".

Një bregë tjetër ndërkombëtare rreth formimit të ushtrisë së Kosovës ka të bëjë me situatën e tendosur të sigurisë në veri të Kosovës, ku serbët etnikë refuzojnë çdo formë të qeverisjes nga Kosova. Vitin e kaluar pati trazira pasi që Policia e Kosovës hyri në një territor për të imponuar zyrtarët doganorë në kufi me Serbinë.

Ili Deda, ish-shëf i stafit të presidentes kosovare, Atife Jahjaga dhe drejtor aktual i Institutit të Kosovës për Kërkime politike dhe zhvillim, beson se edhe në rast të zgjidhjes së situatës në veri, vendet e NATO-s që nuk e njohin pavarësinë e Kosovës mund të mos pajtohen me idenë e formimit të ushtrisë së Kosovës. Ai thotë se Kosova duhet të mbështetet në përkrasit e saj më të mëdhenj.

"Nëse ndodhë një gjë e tillë, ajo do ta ketë mbështetjen e SHBA-së dhe Britanisë", thotë ai. Ky është një mendim i përsëritur nga zyrtarët e Kosovës, sikur që është Çeku.

Procesi

"Ata tani janë duke mbështetur proceset këtu", thotë Çeku. "Dhe, ky proces është i tillë që do ta bëjmë së bashku. Thashë se nuk do të dalë me asnjë rekomandim i cili nuk është i koordinuar me SHBA-në dhe i pranuar nga SHBA-ja".

SHOQËRIA CIVILE

Jahjaga duhet të japë dorëheqje

Emri i saj doli nga zarfi dhe atë për ta udhëhequr vendin për një periudhë jo më të gjatë se njëvjeçare, sa për ta nxjerrë vendin nga ngërçi politik. Presidentja Atifete Jahjaga është rehatuar në postin e të parës së shtetit, ajo nuk e ka ndërmend të japë dorëheqje pavarësisht thirrjeve që vijnë nga vetë ata që e emëruan. Por shoqëria civile mendon se zgjidhja e vetme do të jetë presioni i shtuar ndërkombëtar, derisa akuzojnë partitë politike për mungesë vullneti për t'iu përmbajtur marrëveshjes politike që zgjidhën Jahjagën si presidente

Tribuna

Prishtinë, 25 dhjetor

Presidentja Atifete Jahjaga duhet të japë dorëheqje si akt moral në mënyrë që t'i përmbahej marrëveshjes që e zgjodhi atë, vlerëson shoqëria civile. Ata thonë se në këtë rast po mungon presioni i shtuar ndërkombëtar dhe si faktorë për këtë ngecje i shohin dy liderët politikë, Hashim Thaçi e Isa Mustafa, raporton KTV. Emri i saj doli nga zarfi dhe atë për ta udhëhequr vendin për një periudhë jo më të gjatë se njëvjeçare, sa për ta nxjerrë vendin nga ngërçi politik.

Presidentja Atifete Jahjaga është rehatuar në postin e të parës së shtetit, ajo nuk e ka ndërmend të japë dorëheqje pavarësisht thirrjeve që vijnë nga vetë ata që e emëruan.

Por shoqëria civile mendon se zgjidhja e vetme do të jetë presioni i shtuar ndërkombëtar, derisa akuzojnë partitë politike për mungesë vullneti për t'iu përmbajtur marrëveshjes politike që zgjidhën Jahjagën si presidente.

Arđian Arifaj nga KIPRED-i ka thënë se asnjëra parti nuk ka treguar interes që marrëveshja të respektohet plotësisht.

Ndërkohë Avni Zogiani nga Çohu zvarritjen e procesit për përgatitjen e vendit për zgjedhjet e ardhshme e lidh me mungesën e presionit ndërkombëtar.

Driton Selmanaj nga KDI-ja thotë se partitë politike duhet të largohen nga barrakadimi i tyre në pozicione të ngurta.



Ai thotë se në Kosovë duhet të krijohet një standard, ku marrëveshjet politike respektohen, ndërsa fajin kryesor e hedh te Thaçi e Mustafa.

Atifete Jahjaga nga Policia e Kosovës u bë presidente e vendit në bazë të marrëveshjes së fillimit vitit të 2011-ës të lidhur ndërmjet liderëve të PDK-së, LDK-së dhe AKR-së, e të ndërmjetësuar nga ish-ambasadori amerikan në Prishtinë, Christopher Dell.

Marrëveshja më pas ishte fuqizuar edhe me miratimin e një rezolute nga Kuvendi, me anë të cilës u krijuan dy komisione parlamentare ai për ndrysh-

imin e kushtetutës dhe reformës zgjedhore, në mënyrë që vendi të shkonte në zgjedhje brenda 6 muajsh pas ndryshimeve.

Por Kushtetuesja vlerësoi se Jahjaga mund të vazhdojë të qëndrojë në postin e presidentes, pasi që ajo ishte zgjedhur me votat e deputetëve për një mandat 5-vjeçar.

Presidentja nuk rrezikohet nga Avokati i Popullit

Ditë më parë u tha se presidentja Atifete Jahjaga ka rrezikuar mandatin e saj me rastin e emërimit të Blerim Shalës koordinator të

dialogut politik Kosovë-Serbi.

Ekspertë për çështje juridike kanë vlerësuar se emërimi i Shalës nuk ka mbështetje as kushtetuese e as ligjore, ndërkohë që edhe anëtarë të Gjykatës Kushtetuese kanë konfirmuar se "rasti Shala" përbën hazë të mjaftueshme për t'u trajtuar si lëndë e Kushtetueses. Këtë lëndë, në Gjykatën Kushtetuese mund ta dërgojnë 30 deputetë ose Avokati i Popullit.

Mirëpo avokati i popullit, Sami Kurteshi ka vendosur të distancohet nga ky rast dhe të mos merret fare me të, pasi, sipas tij, aty nuk ka të bëjë fare me ndonjë

shkelje të të drejtave të njeriut, dhe se ky veprim ka qenë totalisht politik.

"Ai emërim është një veprim krejt politik dhe nuk ka asnjë shkelje të të drejtave të njeriut. Është një veprim mes pushteteve të ndryshme. Për Avokatin e Popullit nuk ka kurrëgjë hiq punë këtu", ka thënë Kurteshi për ORAInfo.

Edhe pse një veprim të tillë i lejohet Avokatit të Popullit, Kurteshi plotësisht është i vendosur që mos të merret me këtë çështje, pasi ai thotë se nuk ka kohë të merret me të. "Ne mund të ngremë lëndë kushtetuese dhe kemi të drejt, por nuk ka nevojë me ngrit sepse kjo është një lojë politike ndërmjet pushteteve të ndryshme. Ne kemi me çka me u marrë se kemi mjaftë shkelje", ka thënë Kurteshi, duke u lënë hapësirë që vetë të infiltruarit në këtë çështje të merren me të dhe me zgjidhjen e saj.

"Unë jam Avokat i Popullit, por jo i politikës dhe i Kushtetutës, këtu është problemi. Avokati i ka mundësit t'i mbroj, t'i monitoroj dhe t'i promovoj të drejtat e njeriut. Nuk do të bëjmë asnjë lloj reagimi, se nuk ka nevojë, pasi që aty kurrëgjë si ka mbetur Avokatit të Popullit", ka thënë Kurteshi.

Edhe kryeparlamentari Jaku Krasniqi, ka thënë se është bërë shkelje e Kushtetutës me emërimin e Blerim Shalës si koordinator i dialogut. Ai kishte deklaruar se Shala është dashur me kohë të përcaktohej se cilin funksion dëshiron ta ushtrojë, pasi e ka pasur të qartë se Kushtetuta nuk i jep të drejtë të ushtrojë detyra ekzekutive.

Stars and Stripes: SHBA-të formojnë ushtrinë e Kosovës

Shtetet e Bashkuara të Amerikës dëshirojnë që të formojnë ushtrinë e Kosovës e cila për një kohë sa më të shkurtrë mund t'i bashkohet NATO-s, shkruan portali ushtarak amerikan "Stars and Stripes".

Gati pesë vjet që kur Kosova e ka shpallur pavarësinë,

shumë lojtarë të mëdhenj në skenën ndërkombëtare inkurajojnë Kosovën që të ecë në këmbët e veta.

Njëri nga hapat e parë të Kosovës, siç thekson ky portal, mund të jetë formimi i një ushtrie të vogël nga 2500 pjesëtarët e Forcës së Sigurisë.

"Kjo është punë e vështirë për kombin e ri i cili ende nuk ka signuar pranim të plotë ndërkombëtar dhe ende ka vështirësi që i krijojnë fqinjët verior nga Serbia, nga të cilët e ka shpallur pavarësinë në vitin 2008", thekson ky portal, i cili është i specializuar vetëm për çështje ushtarake.

